

Shëndetësia në shërbim të zhvillimit



RAPORTI 2016

Prishtina
po bëhet



Vizioni:

Një kryeqytet ku jetohet jetë e shëndetshme, ku të gjithë lehtë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për qasje në kujdes shëndetësor.

Misioni:

Krijimi i një mjedisi me qytetarin në qendër, që inkurajon risi dhe përmirësim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, me qëllim të parandalimit, mbrojtjes së shëndetit individual dhe të përbashkët dhe ofrimin e zgjidhjeve efektive dhe adekuate për problemet shëndetësore.



Shëndetësia në Komunën e Prishtinës ka në qendër qytetarin dhe nevojat e tij për shërbime shëndetësore cilësore. Transparenca dhe pjesëmarrja e personelit shëndetësor dhe qytetarëve në vendimmarrje kanë ndihmuar në përmirësimin e shëndetësisë në Komunën e Prishtinës.


Duke qenë se gjatë shumë viteve vendimmarrja është bërë vetëm në nivel të Drejtorisë së Shëndetësisë, nga vitit 2014, buxheti dhe të gjitha vendimet tjera janë marrë në bashkëpunim të plotë me punëtorët shëndetësorë bazuar direkt në kërkesat e qytetarëve direkt ose përmes përfaqësimit të tyre në asamblenë komunale. Sot, në kuadër të zotimit të kryetarit Shpend Ahmeti për “një shëndetësi në shërbim të zhvillimit”, pjesëmarrja aktive qytetare ka bërë që me kritikën dhe sugjerimet e vazhdueshme, shëndetësia në Komunën e Prishtinës të zhvillohet dukshëm dhe ta ketë në qendër qytetarin dhe nevojat e tij.

Gjatë vitit 2016, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është ballafaquar me shumë probleme sidomos sa i përket stafit të pakët në numër, duke filluar nga vetë drejtoria dhe duke vazhduar edhe në njësitë që menaxhohen nga kjo drejtori si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (ËQKMF), Qendra e Mjekësisë Urgjente (QMUO) dhe Qendra për Punë Sociale (QPS).

Pavarësisht kësaj gjatë këtij viti janë organizuar aktivitete të shumta që falë entuziazmit dhe përkushtimit të punëtorëve por edhe të partnerëve të tjerë si Komiteti për shëndetësi pranë Asamblesë Komunale por edhe shumë shoqata dhe Institucione të tjera, janë arritur rezultate të cilat edhe sivjet kanë avancuar shërbimet shëndetësore dhe kanë rritur cilësinë e tyre. Deri në muajin nëntor janë mbi një milion vizita shëndetësore dhe mbi dy milionë shërbime vetëm në QKMF, pa llogaritur Qendrën e Mjekësisë Urgjente. Niveli i referimit në SHSKUK, në këtë vit është nën shifrat 15%, çfarë do të thotë se mbi 85% të pacientëve trajtohen në Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor. Numri i referimeve do të ishte akoma më i vogël nëse nuk do të përfshihej referimet na bazë të caktimeve të terminëve nga stafi brenda SHSKUK-së.

Numri i pacientëve krahasuar me vitin 2015, ka qenë dhe vazhdon të jetë në rritje, sidomos në stomatologji dhe laborator.

Shërbimet shëndetësore (NR.1 253 965)



Në kuadër të investimit në parandalim dhe edukim si praktikë e dëshmuar në çdo vend si praktikë më efikase dhe më pak e kushtueshme, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për të tretin vit radhazi ka vazhduar me vizitat sistematike shëndetësore në shkollat për klasat e I-ra, V-ta dhe të IX-ta.



**Janë kontrolluar
mbi 10.000 nxënës**

Qëllimi i këtyre vizitave bëhet:


- Të përcaktojë rritjen dhe zhvillimin psiko- fizik të fëmijëve.
- Të bëhet identifikimi i hershëm i deformiteteve, anomalive sëmundjeve që janë specifike për moshën dhe marrja e masave të duhura profilaktike kuruese dhe rehabilituese.

Parametrave vlerësues si:

- TMatja e peshës trupore dhe gjatësisë (vlerësim standard sipas diagramit)
- Kontrolli i të pamurit sipas tabelës (Snellen).
- Të dëgjuarit.
- Kontrolli detal klinik i lëkurës, kokës, hundës, gojës, dhëmbëve, gjëndrës tyroide, zemrës, mushkërive, barkut, ekstremiteteve, boshtit kurrizor, gjoksit.
- Zhvillimi psiko- motorik e pjekuria sociale dhe emotive.

Përfshirja e nxënësve në vizita sistematike Viti Shkollor 2015/2016

(NR. 10050)



Gjatë këtij viti, problemet kryesore paraqiten mbipesha, problemet muskuloor-skeletore dhe problemet në të pamën. Kurse niveli i higjienës orale, i cili ka qenë alarmant në vitin e parë të këtyre vizitave, ka përmirësime të dukshme falë masave të ndërmarra nga Drejtoria dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare. Në raport me problemet e këtij viti, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale menjëherë ka hartuar një plan veprimi ku gjatë vitit 2017 do të fillohet me shumë aktivitete informuese dhe konkrete për problemet e paraqitura në vizita e këtij viti. Gjithashtu për të gjitha rastet me patologji të ndryshme janë njoftuar prindërit dhe është bërë referimi i problemit në nivele më të larta.

- ✓ Formimi i Komiteti për Promovim dhe Edukimin Shëndetësor dhe në kuadër të kësaj u organizuan disa aktivitete nëpër çerdhet dhe shkollat e Prishtinës me synim të vetëdijesimit dhe edukimit të fëmijëve rreth shëndetit.

Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre

Ngritja e kapaciteteve në resurse humane ku janë pranuar punëtor shëndetësor shtesë për këtë shërbim

Pajisja e gjithë punëtorëve në shërbim të patronazhit me aparaturnë dhe material të nevojshëm për shërbime cilësore shëndetësore.

Për të siguruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Prishtinës, një nga zotimet e kësaj qeverie ka qenë zonimi i saktë i qytetit, ku secili qytetar do të mund të marr shërbimet afër shtëpisë së tij dhe mjekut në lagje.



Në këtë drejtim është formuar një grup punues me Drejtorinë e Urbanizmit i cili tani më ka filluar punën dhe pritet që ky proces i rëndësishëm të përfundojë në fillim të muajit maj të vitit 2017. Zonimi do të ulë mbingarkesën e disa Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe do të garantojë shërbim korrekt dhe të njëjtë në çdo lagje të Prishtinës.

Duke qenë se në shumicën e Institucioneve shëndetësore nuk është investuar për shumë kohë në infrastrukturën e tyre, kjo ka sjellë kushte të rënda punë për personelin dhe trajtim jo dinjitoz për pacientët. Ngritja e nivelit të cilësisë në Institucionet shëndetësore në Komunën e Prishtinës ka qenë prioritet. Në këtë drejtim ka vazhduar investimi në këtë rrjet duke u bazuar në standardet e reja dhe moderne për infrastrukturë shëndetësore.



Përzgjedhja e shefave dhe personelit të QKMF-ve në bazë të kriterëve në formë transparente e në mbikëqyrje edhe të OJQ-ve, sindikatave e komitetit për shëndetësi.
Rishikimi i shpërndarjes adekuate të personelit dhe rishpërndarja e tyre - bazuar në kriterë transparente dhe sipas nevojës

Gjatë periudhës trevjeçare është investuar dhe janë përmirësuar kushtet teknike në këto institucione shëndetësore në Komunën e Prishtinës:

- ✓ Ndërtimi i QMF XI në Lagjen e Muhaxherëve;
- ✓ Qendra Kryesore e mjekisë familjare – QKMF në qendër;
- ✓ Rehabilitimi dhe Inaugurimi i Objektit të ri në QMF 1;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF 2;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF 4;
- ✓ Krijimi i hapësirave të reja për RO kabinetin stomatologjik QMF 4;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF 5;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF 6;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF 9;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMF – Ish Gjykata;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme QMU;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Viti-Marec;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Slivovë;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Shkllabaj;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Rimanishtë;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Mramor;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Bullaj;
- ✓ Renovim dhe Rehabilitimi i AMF në fshatin Rimanishtë;
- ✓ Renovimi dhe Rehabilitimi i hapësirave të brendshme të njësisë së Dispanzerit Antituberkular – DAT;
- ✓ Gëlqerosja dhe përmirësimi i hapësirave të brendshme Qendra e Mirëqenies së Gruas;
- ✓ Renovimi komplet dhe funksionalizimi teknik i qendrës shëndetësore në Qendrën e Studentëve;
- ✓ Kyçja e Poliklinikës së Stomatologjisë në ngrohjen qendrore;
- ✓ Instalimi i ri portës hyrëse në QKMF Prishtinë;
- ✓ Fillimi i punëve për ndërtimin e një parku të vogël brenda hapësirave të QKMF-së, me qëllim largimin e makinave dhe mundësitë e ecjes së lirshme por edhe të pushimit për pacientët;
- ✓ Renovimi dhe riorganizimi i hapësirave në Qendrën e Mjekësisë Urgjente;
- ✓ Zbrazja e depove nga QMF5, QMF6 dhe Poliklinika stomatologjike të materialit të panevojshëm i cili ka qëndruar me dekada në mënyrë që të rritet hapësira për shërbime për qytetarët;
- ✓ Dyer të reja lëvizëse në QKMF për qasje më të lehtë dhe më praktike për pacientët;
- ✓ Edhe sivjet, janë dezinfektuar mbi 6500 Ha në Komunën Prishtinë, duke shtuar akoma rajone të reja sidomos ato rurale dhe ky dezinfektim është kryer përsëri në 5 faza;
- ✓ Ka mbaruar me sukses procesi i deratizimit të kanalizimeve dhe garazheve;
- ✓ Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në Poliklinikën e Stomatologjisë, Dispanseri-antituberkular;
- ✓ Përmirësimi dukshëm i kushteve për personelin shëndetësor dhe qytetarët në komunën e Prishtinës;

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të resurseve humane dhe teknike për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore si dhe emërimi i koordinatoreve për cilësi si dhe për promovim të shëndetit;
- ✓ Shërbime të reja si ultrazëri i kokërdhokullave tek fëmijët si dhe identifikimi i problemeve tjera ostomuskulare dhe shërbime të reja në stomatologji;
- ✓ Pajisja me të gjitha aparaturat e nevojshme dhe më moderne në të gjitha institucionet shëndetësore në Komunën e Prishtinës, bazuar në kërkesat e stafit shëndetësor;
- ✓ Standardizimi i procedurave, shpalljeve dhe informatave të në të gjitha institucionet shëndetësore

Aktivitetet të shumta për parandalim, promovim dhe edukim shëndetësor


Shërbimi Stomatologjik me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër vendbanimeve të qytetarëve ka bërë që shërbimet stomatologjike nëpër QMF, punktet të cilat kanë punuar vetëm me një ndërrim të punohet tanimë me dy ndërrime. Në QMF IV për shkak të ngarkesës së madhe dhe infrastrukturës së gatshme kemi funksionalizuar edhe një ordinancë me 2 ekipe dhe tani kemi 4 ekipe në dy ordinanca të shërbimit stomatologjik në QMF IV.

Organizimi i punës së kujdestarisë 24 orësh të punëtorit social ku prezenca e punëtorit social është më se e domosdoshme dhe asnjë intervenim apo intervistë pa prezencën e punëtorit social nuk mund të zhvillohet.

Publikimi i revistës së parë shëndetësore “SHËNDETI 038” pas shumë viteve me qëllim të promovimit, edukimit dhe informimit të qytetarëve me mbështetje edhe nga OBSH.



Duke iu përgjigjur nevojave të kohës dhe kërkesave të vazhdueshme nga qytetarët dhe personeli shëndetësor, edhe këtë vit janë bërë investime në aparatura të reja, sidomos në diagnostikë me qëllim të rritjes së cilësisë së rezultateve.



Në këtë drejtim gjatë vitit 2016 janë investuar:

- Rëntgen i ri digjital në poliklinikën stomatologjike
- Rëntgen i stomatologjisë në QMF4 – lagjja të Medreseja
- Ofrimi i shërbimeve diagnostike digjitale të Rentgenit në QKMF Prishtinë
- Ofrimi i shërbimit të ri diagnostik laboratorik (HBa1C) në QKMF Prishtinë (Menaxhimi më i mirë Diabetit dhe kostoja më e lirë për pacientin)
- Ofrimi i shërbimit të ri diagnostik laboratorik (CRP) në QKMF, QKMF-Pediatri, QMF4-Pediatri, QMF5-Pediatri
- Ofrimi i shërbimit të ri diagnostik laboratorik (CRP) në QKMF, QKMF-Pediatri, QMF4-Pediatri, QMF5-Pediatri (Diagnostikimi më i lehtë sëmundjeve infektive, internistike) (Menaxhimi më i mirë i sëmundjeve infektive , internistike dhe kostoja më e lirë për pacientin)
- Instalimi i tetë numëruesve hematologjik modern për laboratorë të instaluar në: QKMF, QMF1, QMF2, QMF5, QMF 6, QMG, QMF 10 dhe QMF 12 për kryerjen e analizave hematologjike
- Instalimi i pesë aparateve biokimike moderne për laboratorë të instaluar në: QKMF, QMF1, QMF3, QMF5 dhe QMF6 (DSHMS),
- Trembëdhjetë karrige për marrjen e gjakut për laboratorë të instaluar në: QKMF 3 copë, QMF1, QMF2, QMF3, QMF 4, QMF7, QMF 10, QMF 12 dhe QMF Hajvali



- Pesë mikroskopë modern për laboratorë të instaluar në: QKMF, QMF1, QMF5, QMF10, QMF12
- Gjashtë analizera (CRP) për laboratorë të instaluar në: QKMF 2 copë, QKMF-Pediatri, QMF5-Pediatria, QMF4-Pediatria (shërbim i ri për herë të parë në QKMF Prishtinë)
- Një analizer (HbA1c) për laborator e instaluar në QKMF-Shërbimi konsultativ për diabet (shërbim i ri për herë të parë në QKMF Prishtinë)
- Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë vendosur 4 defibrilator, 4 ekg, 4 çanta traumatike afër dispeqerit me qëllim që ekipet e ndara sipas numrave t'i vendosin në autoambulanca menjëherë posa marrin ndërrimin.
- Kjo ka ndihmuar që të shkurtohet koha e nisjes nga momenti i thirrjes, këtë e vërteton më së miri audit i punuar, ku në bazë të gjetjeve del se mesatarja e kohës së nisjes nga momenti i thirrjes nga qytetari është 0.56 sec.



Gjatë vitit 2016, në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë edhe këto ditë të fund vitit, ka pasur material harxhues dhe barna si për Laborator, stomatologji dhe Radiologji, duke siguruar punë të pandërprerë të këtyre departamenteve.

Material harxhues dhe barna të mjaftueshme për laborator, stomatologji dhe radiologji

Digjitalizimi i Shërbimeve Shëndetësore



Me qëllim të lehtësimit të punës për personelin shëndetësor, lehtësimit të procedurave për qytetarë dhe shtimit të korrektesisë në mbledhjen e të dhënave statistikore, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale në Komunën e Prishtinës ka realizuar një varg aktivitete:

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka filluar faza e parë e pilot projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor ku janë trajnuar i gjithë stafi për përdorimin e këtij sistemi
- Ka përfunduar komplet Infrastruktura për shtrirjen e rrjetit të Internetit nëpër Qendrat e Mjekësisë familjare dhe është në negociim faza i instalimit të Internetit me qëllim të komunikimit digjital, qasja në protokollet dhe udhërrëfyesit klinik më të fundit dhe ngritjes së nivelit të cilësisë së mbledhjes së të dhënave
- Është bërë instalimi i 50 kompjuterëve të rinj në QKMF, Poliklinikë stomatologjike dhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente
- Është bërë Instalimi i kamerave të sigurisë në QKMF, QMF5, QMF6, QMF4 dhe QMF Mat, si qendra me më shumë pacientë me qëllim rritjen e sigurisë në këto qendra
- Është nënshkruar kontrata për Furnizimin me gjashtëmbëdhjetë laptop dhe projektor për 16 njësi të QKMF-Prishtinë për promovim dhe edukim shëndetësor në shkollat fillore të Prishtinës
- Është nënshkruar kontrata për Furnizimi me Televizor për pritoret e QMF-ve, me qëllim të njoftimit të qytetarëve për shërbimet që ofron Kujdesi parësor në Komunën e Prishtinës, të drejtat e pacientëve dhe edukim dhe promovim të shëndetit përmes informatave vizive për shumë sëmundje dhe si mund të parandalohen ato
- Pas QKMF-së, në bashkëpunim me drejtorinë e administratës është bërë

- Instalimi i aparatit për dhënien e numrave elektronik (laborator) në QMF 5 dhe pritjet që kjo të bëhet ehe në qendrat tjera ku ka shumë pacientë dhe analiza laboratorike
 - Hapja e ueb faqes në QKMF dhe faqes në 'Facebook' ku qytetarët informohen vazhdimisht mbi aktivitetet dhe të drejtat e tyre në këto institucione
 - Përfundimi i ueb faqes në QMU dhe pritjet hapja e saj në ditët në vazhdim, me qëllim të informimit sa më korrekt të qytetarëve
 - Instalimi dhe shumë shpejt futja në përdorim të aparaturave për monitorimin e orarit të punës
 - Sistemi i informimit në shëndetësi, çdo banorë ka kartelën e vet digjitale Hapja e faqes elektronike në QKMF si hap i parë i informimit mbi shërbimet dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore <http://qkmf-pr.org/> Instalimi i sistemit të menaxhimit të radhës në njësit laboratorike. Në këtë drejtim ka filluar edhe harmonizimi i aparaturave me këtë sistem duke instaluar aparaturat digjitale që lidhen me sistemin e digjitalizimit si rëntgeni digjital, aparatet laboratorike, EKG-te e të tjera.
- ✓ Instalimi dhe funksionalizimi i sistemit digjital "PARATUS" në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, që digjitalizon përmes tabletëve dhe hartave të para-instaluara, shërbimet urgjente në teren duke lidhur terrenin me Qendrën e Mjekësisë Urgjente dhe Qendrën Emergjente në QKUK, për të shkurtuar kohën e veprimit.

Gjatë këtyre tre viteve në mënyrë të vazhdueshme është bërë ngritja e kapaciteteve të shërbimeve, resurseve humane dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional.

Edhe përkundër numrit të vogël dhe të pamjaftueshëm të stafit në QKMF, QMU dhe QPS, por edhe zvogëlimit të buxhetit nga granti qeveritar për shëndetësi me rreth 35%, falë angazhimit dhe përkushtimit të punëtorëve në këto qendra cilësia e shërbimeve vetëm sa është rritur.



Në këtë drejtim Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në koordinim të plotë me këto njësi gjatë vitit 2016 ka bërë me dhjetëra aktivitete:

- Në QKMF Prishtinë janë organizuar mbi 15 ligjërata interaktive profesionale të akredituara nga MSH ku kanë qenë të përfshirë i tërë stafi mjekësor dhe i mesëm nga ligjërues të njohur të fushave përkatëse me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve
- Pas shumë kërkesave nga bashkësia lokale e Bardhoshit, kjo qendër tani më ka filluar punën në dy ndërrime ku qytetarët e Bardhoshit dhe fshatrave përreth, mund të marrin shërbime shëndetësore gjatë gjithë ditës. Në kuadër të premtimit të Kryetarit Ahmeti, është përgatitur plani operacional që çdo shkollë do të ketë mjekun apo infermierin e vet të cilët vazhdimisht me laptop dhe projektorë do të mbajnë ligjërata dhe edukim e promovim të shëndetit nëpër çdo shkollë të Komunës së Prishtinës, me qëllim të vetëdijesimit dhe marrjes së përgjegjësisë për shëndetin
- Në bashkëpunim me QKUK-Klinika Emergjente është realizuar trajnimi mbi Kirurgjinë e Vogël, ku 24 Mjek familjar dhe Infermier janë aftësuar në trajtimin plagëve minore, dhe tash e tutje pacientët e tillë mund të trajtohen edhe në QKMF-Prishtinë
- Në bashkëpunim me QKUK-Klinika Interne (Endokrinologjia) është realizuar trajnimi mbi Menaxhimin e Diabetit ku 30 Mjek familjar dhe Infermiere janë aftësuar në trajtimin e pacientëve Insulinë marrës dhe tani të gjithë këta pacientë do t'i marrin këto shërbime afër shtëpive të tyre nëpër QMF-të përkatëse
- pa pasur nevojë të vinë në QKMF
- Është hartuar plani i veprimit për vitin 2017 që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe me trajnime të tjera konkrete bazuar në të dhënat për sëmundshmërinë në Komunën e Prishtinës
- Është organizuar punëtori mbi menaxhimin e dhembjes
- Për herë të parë në Komunën e Prishtinës filloi ekzaminimi sistematik i kokërdhokullave në Njësinë e Pediatriisë pranë QKMF-së
- Për herë të parë në Komunën e Prishtinës filloi ekzaminimi dhe diagnostikimi i Shputës së Rrafshët me aparaturat përkatëse për fëmijët
- Për herë të parë në Komunën e Prishtinës filloi ekzaminimi dhe diagnostikimi i problemeve të shtyllës kurrizore përmes mjeteve përkatëse
- Për herë të parë në Kosovë, në bashkëpunim me partner si Action for Mother and Children, OBSH, UNFPA dhe SHSKUK, ka filluar skringu i kancerit të qafës së Mitrës dhe deri tani janë mbi afër 2000 gra të komunës së Prishtinës që janë ekzaminuar. Pritet që e njëjta të fillojë në vitin 2017 për kancerin e gjirit
- Për herë të parë në Komunën e Prishtinës u hap qendra stomatologjike për preventivë, ku përveç intervenimit, jepen vazhdimisht këshilla për mbrojtjen e dhëmbëve dhe parandalimit të sëmundjeve të tyre
- Është organizuar trajnim mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe menaxhimi i tyre

- Është organizuar trajnim mbi menaxhimin e Diabetit
- Është organizuar punëtori mbi leximin korrekt të EKG-se
- Është organizuar trajnim për këshill dhënie për planifikim familjar
- Është organizuar trajnim për evidentimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës bazuar në gjini
- Është organizuar kurs për dhënien e ndihmës së parë bazuar në Mbështetjen themelore të jetës – AED
- Është organizuar trajnim i stafi për ekzaminimin korrekt me otoskop dhe oftalmoskop
- Planifikimi dhe organizimi i trajnimit të stafit shëndetësor të QKMF Prishtinës për evidentimin e të dhënave në kartelën elektronike. (Trajnimi i 543 punëtorëve shëndetësor)
- Në QMU në QET është mbajtur kursi njëditor Mbështetja Themelore e Jetës dhe përdorimi i Defibrilatorit (BLS-D) me qëllim të edukimit të vazhdueshëm profesional të stafit
- Në QMU janë mbajtur shumë ligjërata të cilat kanë pasur si qëllim përmisimin e reagimit të shpejtë në rastet urgjente si: Ndryshimet në protokollin e RKP 2015 sipas AHA; Menaxhimi para spitalor i fatkeqësive/incidentëve me viktima masive; Hulumtim mjekësor
- Sfidat e Q.M.U-së, Kërkesat –Natyra e thirrjeve; Plotësimi i formularëve-dokumentacionit mjekësor (Audit); Trajtimi i hipertensionit me fokusim në kushtet para spitalore, Hipertensioni arterial, Kujdesi infermieror; Mesatarja e arritjes së ekipeve të QMU-së, në vendndodhje (Audit) e shumë ligjërata e aktivitete të tjera
- Ligjërata nëpër shkollat e Prishtinës me qëllim rritjen e vetëdisimit dhe edukimit shëndetësor
- Shënimi i ditës kundër HIV-AIDS
- 21-28 Janar 2015- Java e preventimit të kancerit të qafes së mitrës
- 20 - 21 Mars- Shëndeti oral -Buzëqeshi jetës
- 24 mars - Dita boterore e luftës kundër TBC
- Prill 2015 - Java Evropiane e Imunizimit
- 12 maj - Dita e Infermierisë
- 17 maj - Dita e hipertensionit
- 31 maj - Dita boterore pa duhan
- 26 qershor - Dita nderkombetare kundër drogës
- 29 Shtator- Dita nderkombetare e zemres
- 30 shtator - Dita e promovimit e gjidhënjës
- Tetor - Muaji i luftes kundër kancerit të gjiri
- U mundësua mamografia falas për 100 femra të rasteve sociale gjatë tërë muajit
- 14 Nëntor - Dita boterore kundër diabetit



- Janë mbajtur shumë auditime nga Komiteti për cilësi me qëllim të identifikimit të problemeve dhe zgjedhjen e tyre si
 1. Hulumtimi mbi kënaqshmërinë e pacientëve
 2. Hulumtim mbi mbushjen e dokumentacionit shëndetësor
 3. Hulumtim mbi raportet e vazhdueshme nga kutitë e ankesave etj.
- Organizimi i shumë trajnimeve dhe ligjëratave me qytetarë që vuajnë nga sëmundje të ndryshme kronike me qëllim të informimit të tyre për këto sëmundje

MIRËQENIA SOCIALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Pas përfundimit të ndërtimit dhe sanimit të shumë problemeve teknike në 50 banesat e dedikuara për dhënie në shfrytëzim familjeve në nevojë, dhe përgatitjes disa mujore për mbarëvajtje të procesit, pas formimit të Komisionit për ndarjen e këtyre banesave ka filluar procesi i ndarjes së tyre. Kanë aplikuar mbi 300 familje dhe i gjithë procesi po zhvillohet në prani të vëzhguesve të shumtë nga shoqëria civile, mediat dhe Institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe konform afateve kohore do të shpallen rezultatet përmes sistemit të pikëzimit i cili do të jetë komplet transparent dhe i qasshëm për publikun dhe të interesuarit në mënyrë të vazhdueshme.



Përkrahje famijeve pa kulm mbi kokë dhe atyre në gjendje të rëndë ekonomike

Në fund të vitit 2015, **11 familje u larguan nga kontejnerët** ku kishin banuar me vite të tëra pa kushte elementare për jetë. Të gjitha këto familje tani jetojnë në shtëpi/banesa qiranë e të cilave i paguan Komuna e Prishtinës.

Gjatë periudhës tre vjeçare, **mbi 10 familje tjera** të cilat kishin mbetur pa kulm mbi kokë për arsye të ndryshme janë ndihmuar nga Komuna e Prishtinës. Edhe këto familje **janë vendosur në shtëpi/-banesa**, qiranë e të cilave e paguan Komuna.

Për tre vjet radhazi, Komuna e Prishtinës ka bërë shpërndarjen e më shumë se **500 metra dru kub nga 2 metra për 100 familje në secilin vit.**

Çdo vit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka ndarë **subvencione** ndihmë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Duke parë nevojën e madhe për ndihmë sociale në vitin 2014 kemi ndarë 100,000.00 euro ndërsa në vitin 2015 e kemi trefishuar shumën në 290,000.00 euro. Gjatë vitit 2015 ka pasur rreth 2500 aplikime për subvencione të kategorive sociale dhe trajtimeve mjekësore. Janë ndarë subvencione për rreth 1500 familje nga kategoritë sociale dhe rreth 650 për trajtime mjekësore. Janë ndarë subvencione edhe për 15 familje pas fatkeqësive

natyrore. Shuma totale e shpërndarë në këto raste është rreth 290.000 Euro. Në vitin 2016, kanë aplikuar mbi 2300 qytetarë dhe familje të ndryshme për nevoja të ndryshme qoftë sociale apo shëndetësore. Janë përkrahur **1910 familje**, individ dhe OJQ që përfaqësojnë kategori të ndryshme me nevoja specifike. Shuma e subvencioneve për vitin 2016 ka qenë 290,000.00 euro.



